

Deri te:

Këshilli mësimor-shkencor i Fakulteti Filozofik –Universiteti i Tetovës

Në bazë të vendimit të Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës nr.16-556/2 nga mbledhja e mbajtur me të mbajtur më 14.05.2018 për formimin e komisionit për vlerësimin disertacionit të doktoraturës me titull “Zhvillimet historike në Llap dhe Diplomacia Evropiane 1912-1963” të kandidatit Mr.sc.Sadri Rexhepi, Komisioni në përbërje Prof. Dr.Vebi Xhemali (kryetar), Prof. Dr. Zeqirja Rexhepi (anëtar), Prof.Dr.Nuri Bexheti (anëtar), Doc.dr.Isak Sherifi (anëtar), Prof. Dr. Zeqirja Idrizi (mentor), Këshillit Mësimor-Shkencor të fakultetit në fjalë i paraqet këtë:

Raport

për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës

Mr. Sadri Rexhepi është lindur në fshatin Tenezhdoll të Prishtinës. Shkollën fillore e mbaroi në Lupç të Poshtëm. Kurse shkollën e mesme Akademinë Pedagogjike në Prishtinë, ku e mbaroi edhe Fakultetin Filozofik Degën e historisë në vitin 1983. Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Prishtinës dhe te Novi Sadit me 14 janar të vitit 1988 me sukses të shkëlqyeshëm. Për aktivitetin politik e antijugosllav, veçmas pas vitit 1981 përjetoi krajata të shumta politike. Për këtë arsye u diferencua dhe u përjashtua në disa shkolla e gjithashtu u pengua që të mbronte edhe temën e magjistraturës. Së këndejmi, për një kohë ishte bashkëpunëtor i Rilindjes. Megjithatë ai punoi në disa shkolla të Besianës dhe Prishtinës . Ka ndjekur studimet për specializim në Institutin për Studime Evropiane pranë Universitetit të Gotingenit në Gjermani. Prej shumë vitesh merret me publicistikë, nga lëmi i kulturës dhe shkencës historiografike dhe deri tani Sadri Rexhepi ka botuar shumë zëra bibliografik artikuj, kritika, recensione, trajtesa, studime në shtypin ditor, javor, mujor dhe në revistat shkencore. Ka marrë pjesë në tubime e simpoziume shkencore në Kosovë dhe jashtë me trajtesa të ndryshme. Prej shkurtit të vitit 1990 deri në maj të vitit 1992 përfaqësonte Llapin në Këshillin Qendror të Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve . Gjithashtu në fillim të vitit 1990 ishte iniciator për themelimin e sindikatës së pavarur të arsimit në Kosovë . Për pesë vjetë me radhë 2000- 2005 ishte anëtar i komisionit për standrtizimin e rrugëve dhe vendbanimeve në Kosovë . Prof. Mr. Sadri Rexhepi aktualisht është kryetar i Lidhjes së Historianëve të Kosovës „ Ali Hadri ” për komunën e Prishtinës. Per disa vite rresht ishte ligjërues në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë dhe Gjilan.

Temat qe trajton kandidati Mr.sc.Sadri Rexhepi kanë të bëjnë me të kaluarën e hidhur apo më mirë më thënë krajetatë nëpër të cilat kaloi populli shqiptar të cilat me atë rast ai i arsyeton dhe argumenton qëllimet e trajtimit të temave duke theksuar vështirësitë ekonomike, politike, shoqërore, dhe kulturore nëpër të cilat kaloi populli shqiptar në Jugosllavinë e para dhe pas Luftës së Dytë Botërore e që janë temë bosht i trajtesave të tij. Kandidati gjithashtu bën të ditur për metodat hulumtuese-shkencore të përdorura në hartimin e studimeve si dhe për literaturën dhe bibliografinë e përdorur gjatë hartimit të tyre. Në veçanti kandidati bën një qasje kritike dhe të argumentuar, gjithnjë mbi bazën e fakteve arkivore të momentit kur janë zhvilluar ngjarjet dhe veprimtarinë e sakrificën e atyre që dhanë jetën për të mirën e popullit shqiptar dhe në mbrojtje të atdheut në sytë e diplomacisë evropiane. Segmente të veçanta të cilat i trajton kandidati janë, ato që kanë të bëjnë me burgosjen dhe dënimin e veprimtarëve, martirëve, dëshmorëve, dhe heronjve të popullit . Në këtë pikë kandidati bën përpjekje të argumentuara që të jep vlerësime mbi shkaqet që e sollën në një gjendje tepër të rëndë politike popullin shqiptar përballë mizorive serbe dhe më mjaft shembuj dhe detaje studimore trajton thellimin e veprimtarisë së shumë personaliteteve të kohës kur vepruan. Segment të veçantë të trajtimit këtu zë edhe qëndrimi kombëtar i shumë veprimtarëve të cilët kritikonin haptas udhëheqjen e pushtetit të përberë vetëm nga serbët që kishin sjellje shumë të këqija ndaj shqiptarëve dhe kërkonin ndarjen e pushtetit në mes të shqiptarëve dhe serbëve, edhe pse 99% e popullsisë ishte shqiptare...

Në vazhdim kandidati, gjithnjë përmes analizimit të burimeve shtjellon, mënyrat, metodat, strategjinë, e qeverisjes antishqiptare nga pushtetarët serb duke u ndalur në çështjet e spastrimit etnik të shqiptarëve, burgosjen e veprimtarëve shqiptarë të cilët merrnin guxim për të kundërshtuar padrejtësinë e pushtetit serb.

Kandidati me një qëndrim objektiv të paanshëm hulumtues trajton zhvillimet tejet dramatike në atë periudhë tepër dramatike për shqiptarët në ish Jugosllavi si një ndër vitet më të vështira nëpër të cilat po kalonte populli shqiptar në njërin anë e në anën tjetër aktivitetet e veprimtarëve që ishin në vllugun më të madh deri në luftën e fundit shqiptaro-serbe, qe kurorëzohet me çlirimin e Kosovës. Në fushë të dijesë historiografike Rexhepi me emër të tij, e me pseudonime deri tani ka publikuar rreth 300 zëra bibliografik, artikuj, trajtesa, recensione e kritika te ndryshme, fejtone, e studime historiografike. Përpos atyre Rexhepi botoi edhe keto vepra historiografike;

- Një Jetë për Atdhe Gjuhë e Flamur, 2000
- Jeta dhe Veprimtaria e Ramadan Bogujevcit, 2001
- Masakra e Dyzit, 2003
- Majasi-lugina e Kaçanollit me rrethinë 1912-2000 (bashkautor Prof. Dr. Fehni Krasniqi), 2006

- Shaban Shala Hero i Shqipërisë Etnike, 2012
- Shaban Shala Mësues dhe Veprimtar i Shqipërisë Etnike, 2016
- Shaban Tenezhdolli, 2017

Po kaq libra ka në dorëshkrim, të cilët së shpejti presin dritën e botimit.

Tema e doktoraturës e kandidatit Sadri Rexhepi hapet me pjesën hyrëse në të cilën kandidati arsyton dhe argumenton qëllimet e trajtimit të temës në fjalë, duke theksuar vështirësitë ekonomike dhe politike nëpër të cilat kaloi populli shqiptar në Jugosllavinë e pas Luftës së Parë Botërore janë temë bosht i trajtesës. Në këtë pjesë, kandidati gjithashtu bën të ditur për metodat akademike të përdorura në hartimin e temës së doktoraturës si edhe për literaturë dhe bibliografinë e përdorur gjatë hartimit të temës së sipërcekur. Kandidati në vijim temën e ndan në pesë kapituj të grupëzuar në disa nënkapituj. Studimi, përkatësisht tema e Disertacionit të Doktoratës, “Zhvillimet historike në Llap dhe Diplomacia evropiane 1912 – 1963” është fryt i një pune të gjatë hulumtuese. Ajo është hartuar në mbështetje të një metodologjie bashkëkohore në punën kërkimore-shkencore. Për hartimin e saj është punuar në dy drejtime themelore: së pari, është mbledhur çdo fakt i vlefshëm, burim relevant shkencor që ka të bëjë me begatimin e historisë së trevës së Llapit për periudhën që është objekt trajtimi. Së dyti, të dhënat dokumentare janë seleksionuar, analizuar, krahasuar dhe sistemuar në bazë të një metodologjisë shkencore, sipas parimit kronologjik dhe, sipas rëndësisë së tyre, duke synuar të përfshihet në këtë monografi një tablo sa më e plotë e fakteve, të dhënave historike për këtë trevë. Megjithatë studimi mbështetet në burime dokumentare të arkivave të ndryshme dhe arrijtet e deritanishme shkencore, i cili synon të plotësojë dhe të zgjerojë njohurit mbi historinë dhe zhvillimin e shumë ngjarjeve me rëndësi historike, politike, etnografike të Llapit në përgjithësi dhe rolin e tij të veçantë në këtë periudhë të rëndësishme të historisë sonë kombëtare. Studimi mund të paraqesë një ndihmesë për ta hartuar në të ardhmen një monografi të plotë për historinë e gjithmbarshme të shqiptarëve të Kosovës, e cila padyshim do të ishte një vepër me rëndësi të madhe në jetën shkencore të këtij populli.

Si rrjedhojë, tema përkatëse e Disertacionit të Doktoratës me titull, “Zhvillimet historike në Llap dhe Diplomacia evropiane 1912 – 1963” është e ndarë në pesë kapituj.

Kapitulli i parë përfshin periudhën prej vitit 1912 e deri në vitin 1918. Fillimisht në këtë kapitull bëhet fjalë për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë londineze në vitin 1912, Luftën e Parë dhe Luftën e Dytë Ballkanike, si dhe vendimet e padrejta të Konferencës së Londrës të vitit 1913, sepse ia shkëputi Shqipërisë etnike rreth 65 mijë kilometra katror. Ndërkaq, kur është fjala për territoret të cilat ishin të banuara me shqiptarë autokton e që mbeten jashtë Shqipërisë natyrale, nën sundimin e shteteve sllave: Serbisë, Malit të Zi, Greqisë dhe Bullgarisë, iu nënshtuan dhunës

së aparateve shtetërore, varësisht se ku ishin, deri në përmasa gjenocidale. Pas atyre zhvillime tejet tragjike për kombin tonë shqiptar, për shqiptarët të cilët mbeten jashtë kufijve të Shqipërisë etnike, filloi një ndër periudhat më të rënda, sepse, populli i ndarë shqiptar iu nënshtrua dhunës sistematike, të paparë, si dhe masakrave të ndryshme deri në përmasa gjenocidale dhe etnocidale. Me këtë rast një pjesë e popullatës shqiptare u ekzekutua aty për aty, kurse një pjesë nga format e dhunshme gjenocidale u detyrua të shpërngulej në Shqipëri, Turqi dhe vende të tjera të Evropës, Amerikës dhe botës.

Mirëpo, pengimin e shfarosjes dhe shpërnguljes masive së popullatës shqiptare nga trojet e veta autoktone e ndaloi fillimi i Luftës së Parë Botërore 1914/1918. Në këtë fazë, falë përkrahjes së madhe, të fuqishme që Perandoria Austro-Hungareze i dha kombit tonë mbarë, kombi ynë përfitoi të drejta të caktuara, ndër to, u lejoi të hapnin shkolla shqipe dhe të drejta të tjera. Por e rëndësishme ishte se, periudha e Luftës së Parë Botërore pamundësoi, së paku përkohësisht që, kombet sllave përreth Atdheut Shqiptar të pushtonin territore shqiptare.

Kapitulli i dytë përmban ngjarje të rëndësishme historike ndërkombëtare, të cilat, shumëfish ishin në dëm të çështjes shqiptare. Në atë periudhë ndodhi Konferenca e Paqes në Versajit afër Parisit (1919/1920) në të cilën u dëmtua rëndë çështja shqiptare. Me këtë rast u legjitimua padrejtësia ndërkombëtare e Londrës ndaj tokave shqiptare. Megjithatë, një fakt ishte pozitiv sepse shpëtoi për tu ri copëtuar Shqipëria Londineze, ashtu siç ishte planifikuar nga shtetet e Ballkanit, por edhe me Traktatin e fshehtë të Londrës të vitit 1915. Në këtë fazë filloi ndjekja (rrëfija) e familjeve të tjera shqiptare nëpër fshatrat e ndryshme të Kosovës. Edhe në krahinën e Llapit ndodhi djegia e shumë fshatrave shqiptare, sikurse Lupçi i Epërm, Lupçi i Ulët, Majaci, Penuha, Dumnica e Krasniqes, Breznica, Gërdofci, etj. me ç'rast shqiptarët u dogjën për së gjalli rreth e përçark sanove, rreth e përçark shtëpive, nëpër bodrume, ahura, stalla, plevica, ku i lidhnin dhe i ndiznin e i digjnin për së gjalli bashkë me të mirat materiale që ndodheshin në shtëpi.

Një tragjedi të këtillë nuk e kishte përjetuar asnjë popull tjetër. Shumë prej këtyre familjeve u eliminuan tërësisht në mënyrën më mizore që nuk kishte parë historia. Sipas deklaratës së një serbi i cili vetë ka qenë në këtë kohë në Llap, ka thënë se janë vrarë 12 mijë e 700 veta, secili në mënyrën më mizore se tjetri.

Për këtë arsye figura më patriotike nga radhët e shqiptarëve, pikërisht nga treva Veriperëndimore e Kosovës, patrioti, Nazim Gafurri e kishte shitur pasurinë familjare dhe kishte shkuar në Shkup. Gjatë qëndrimit në Shkup, i cili qytet që atëherë popullohej me shumicën shqiptare, paguan disa gazetarë me qëllim që të përhapin lajme tronditëse që ndodhnin ndaj shqiptarëve në tërë Kosovën, e në këtë rast edhe në Llap. Bota e qytetëruar kur dëgjoi për këto represalie të tmerrshme me përmasa gjenocidale që zhvilloheshin ndaj shqiptarëve duarthatë e të pambrojtur, dërgon në

Kosovë një komision ndërkombëtar për të verifikuar gjendjen reale se në ç' përmasa ka arritur gjenocidi serbo-sllav ndaj shqiptarëve në Kosovë. Me këtë rast edhe në Llap, me të njëjtin qëllim, pra, që të parandalojë këtë gjenocid dhe të shpëtojë ata shqiptarë të cilët kishin shpëtuar pa u vrarë dhe pa u shpërngulur kishte arritur një Komision ndërkombëtar. Komisioni në fjalë u habit kur dëgjoi se në ç' shkallë kishte arritur dëbimi, masakrimi i shqiptarëve, andaj Komisioni bëri vërejtje serbëve që të ndalnin gjenocidin. Autoriteteve serbo-sllave u thanë që të ndërprejnë gjenocidin ndaj shqiptarëve të pafajshëm, të cilët edhe sipas konstatimeve, vlerësimeve të Komisionit ndërkombëtar ishin në trojet e veta autoktone. Organet serbe kur kuptuan se patrioti i madh i Prishtinës, Nazim Gafurri, kishte njoftuar organizmat evropian për gjenocidin serb në Kosovë, organizuan, mjerisht përmes spiujve të vet shqiptarë dhe serbë, vrasjen e patriotit Nazim Gafurri.

Kapitulli i tretë përmban të dhëna mbi pushtimin e Jugosllavisë nga ana e nazifashistëve gjermanë e italianë në vitin 1941, me ç' rast edhe trojet shqiptare bien nën sundimin e nazifashistëve gjerman e italian. Për shqiptarët lind një periudhë e re, të cilën e konsideruan si çlirim, ngase ata fituan një nivel të caktuar të drejtave. Ndër ato të drejta, të cilat luajtën rol të madh në emancipimin politik, kombëtar dhe jo vetëm kulturor të popullsisë së atëhershme shqiptare duhet përmendur hapjen e shkollave në gjuhën shqipe, të drejtën e përdorimit të flamurit shqiptar, përdorimi publik e zyrtar i gjuhës shqipe në administratë e kudo tjetër, punësimin e një numri të vogël të shqiptarëve etj.

Në kuadër të kapitullit të tretë, trajtoj mbajtjen e Lidhjes së Dytë të Prizrenit, më 16 shtator 1943, në të cilin tubim kombëtar të shqiptarëve dhanë kontribut të vlefshëm edhe shqiptarët e Llapit, pra të trevës Veri Perëndimore të Kosovës.

Kapitulli i katërt përfshinë periudhën historike prej vitit 1944 e deri në vitin 1949, periudhë kjo që përcillet përsëri me shumë tragjedi për popullin shqiptar. Themi kështu duke u bazuar në të dhënat se në këtë periudhë vendoset administrimi ushtarak në Kosovë më 8 korrik 1945. Kjo fazë përcillet me tragjedi të llojllojshme mbi shqiptarët e pafajshëm dhe të pambrojtur, mbi të cilët zhvillohet një gjenocid i tmerrshëm, me ç' rast vriten rreth 72 mijë veta, sipas shënimeve që posedonte NDSH-ja.

Në të vërtetë kjo ishte periudha më e tmerrshme që kishte përjetuar populli shqiptar ndonjëherë, si dhe masakrën e Tivarit, varrit më të madh në Evropë, ku janë vrarë e masakruar 4 mijë e 600 shqiptarë. Në mesin e të vrarëve dhe të masakruarve kishte edhe shumë shqiptarë nga regjioni i Llapit. Edhe sot ka shqiptarë në Llap të cilët fatbardhësisht i kanë shpëtuar masakrës së Tivarit dhe tregojnë për tmerret që kanë përjetuar shqiptarët në atë purgator (ferr). Periudha kohore prej 1945 e deri në vitin 1949 përshkohet deri në fund me tragjedi, dhunë, terror e

reprezalje ndaj shqiptarëve kudo në Kosovë, por edhe në rajonin e Llapit, të planifikuara nga regjimi pushtues serb.

Kapitulli i pestë përfshinë periudhën prej vitit 1949 e deri në vitin 1963, periudhë kjo në të cilën formohen dy Organizata nacional demokratike (NSH) në rajonin e Llapit, që ishin të vetmet në Kosovë në atë kohë. NDSH-ja e parë për Llap është formuar në vitin 1949 në krye me Sabit Kapitin dhe ka vepruar deri në vitin 1953 deri sa janë zbuluar dhe janë dënuar me nga 5 vite burg anëtarët e saj. Ndërkaq, NDSH-ja e dytë në Llap është formuar në vitin 1957 në krye me Shaban Shalën dhe ka vepruar deri në vitin 1962 deri sa anëtarët e saj, janë zbuluar dhe janë burgosur dhe dënuar me shumë vite burg. Për kontributin në NDSH-ën e dytë vlen të përmendet Shaban Shala, i cili ishte anëtar edhe në NDSH-ën e parë, kurse në të dytën ishte kryetar. Ai është likuiduar barbarisht një natë para se të lirohej nga burgu. Në këtë fazë vlen të përmendet aksioni famëkeq i ashtuquajtur “Aksioni i Armëve”(1955 / 1956), i cili u instalua nga pushteti serb/jugosllav, me ç’ rast shumë llapjan iu kanë nënshtruar torturave të egra dhe çnjerëzore nga të cilat shumë shqiptarë kanë vdekur nga reprezaljet aty për aty, ndërkaq një pjesë e madhe e tyre kanë mbetur fizikisht apo psikikisht të pa aftë deri në vdekje. Po në atë kohë, ka ndodhur edhe konfiskimi i ushqimit të shqiptarëve, kinse në emër të tepricave (vishak), ju është marrë drithi, gruri, mistri, buka prej gojës, edhe mielli në magje. Me aksionin famëkeq, antishqiptar, Mbledhja e Armëve dhe me aksionin po ashtu antishqiptar, Mbledhja e tepricave (Vishaku - tepricë) pushteti, regjimi pushtues serbo/jugosllav kishte për synim të dobësonte rezistencën e Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës dhe t’i detyronte shqiptarët për tu shpërngulur nga vatrat e tyre. Në atë kohë ndodh aksioni i shpërnguljeve të mijëra familjeve shqiptare nga Kosova për në Turqi, që ishte rezultat i gjenocidit shtetëror serbo/jugosllav, ndërkohë që diplomacia evropiane kishte heshtur. Vlen të përmendet se platforma kombëtare e Programit të NDSH-së kishte të bënte me hapjen e shkollave shqipe, me zhdukjen e analfabetizmit, ndërprerjen e shpërnguljes së shqiptarëve për në Turqi dhe çlirimin e Atdheut nga okupatori serb dhe me bashkimin e Kosovës dhe të viseve tjera shqiptare në ish Jugosllavi me Shqipërinë, shtetin amë.

Ai në vazhdim pasi trajton emërtimin e hidronomit Llap paraqet rrethanat e përgjithshme shoqërore, politike, ekonomike dhe nepër të cilat ka kaluar populli shqiptar në Lëvizjen çlirimtare në shekullin XIX-XX. Në këtë pikëvështrim kandidati shtjellon krajetat që përjetoi populli shqiptar pas pushtimit të parë me 1912. Në veqanti kandidati bën një qasje kritike dhe të argumentuar, gjithnjë mbi bazën e faktëve arkivore të momentit kur u pushtu Llapi dhe Kosova dhe kohën kur linden celulat e para të lëvizjes kaçake për të mirën e popullit shqiptar dhe edukimin e tij me trimerinë e Demë Ahmetit. Kandidati trajton edhe edhe rënien e Kosovës nën sundimin asustriak gjatë Luftës së Parë Botërore 1914-1918. Segmente të veçanta të cilat i

trajton kandidati janë, ato që kanë të bëjnë me hapjen e shkollave në Kosovë. Kandidati me mjaft shembuj dhe detaje studimore trajton thellimin e veprimtarisë së çetave kaçake. Në këtë pikë kandidati bën përpjeke të argumentuara që të jepë vlersimin mbi shkaqet që e sollën në një gjendje tepër të rëndë politike popullin shqiptar përballë mizorive serbe. Më tutje trajtohet thellimi i aktivitetit të çetave kaçake. Nazim Gafurri ka dhënë kontributin e tij në këtë aspekt dhe kërkesat për ndërrimin e pushtetit të asaj krijese artificiale në raport me sjelljet e këqia politike ndaj popullit shqiptar në mes dy luftërave botërore. Këtu behet fjalë edhe për „çlirimin” e viseve shqiptare gjatë okupimit nazi-fashist gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Segment të veçantë të trajtimit këtu zë edhe qendrimi kombëtar i shumë personaliteteve pas Luftës së Dytë Botërore veçmas i Shaban Shalës i cili kritikonte haptas udhëheqjen e pushtetit të përbërë vetëm nga serbët dhe kërkonte ndarjen e pushtetit në mes të shqiptarëve dhe serbëve, pasi që 98% e popullsisë ishte shqiptare .

Në kapitujt e tjerë të temës së doktoratës kandidati Rexhepi perfshin trajtimin e historisë antishqiptare, krizat e qeverisë serbe si dhe objektivat dhe te arriturat në radhet e shqiptarëve. Ne vazhdim kandidati, gjithnjë përmes analizimit të burimeve shtjellon menyrat, metodat, strategjinë e qeverisjes antishqiptare nga pushtetarët serb duke u ndalur në çështjet e spastrimit etnik të shqiptarëve, burgosjen e veprimtarëve të radhitur në NDSH-e të cilët merrnin guxim për të kundërshtuar padrejtësin e pushtetit serb. Këtu trajtohen edhe pasojat e aksionit famëkeq të armëve në Kosovë si dhe qendresen e veprimtarëve shqiptarë në burgjet e Jugosllavisë së pas Luftës së Dytë Botërore, gjatë aksionit famëkeq të armëve. Kandidati gjithnjë përmes analizimit të burimeve fokusohet në vitin 1957 kur themelohet NDSH-ja e re e kryetar emerohet Shaban Shala ku analizon vështësitë por edhe sukseset që shënoi NDSH-ja duke vendosur flamujt kombëtar pa yllin pesë cepesh në të gjithë Kosovën dhe në trenin që qarkullonte nga Fushë Kosova për në Beograd. Kandidati me një qëndrim objektiv të paaneshëm hulumtues trajton zhvillimet tejet dramatike në atë periudhë tepër dramatike për shqiptarët në ish Jugosllavi si një ndër vitet me të vështira nëpër të cilat po kalonte populli shqiptar në një anë e në anën tjetër aktivitetet e ONDSH –së ishin në vllugun më të madh. Segment i trajteses janë edhe burgosjet e anëtarve të NDSH-së si edhe likundimi i Shaban Shales në burgun e Prishtinës pas shumë torturave. Edhe këtu kandidati synon që të mbajë një qëndrim të matur, objektiv dhe realist duke u mbështetur në burimet dhe literaturën. Në përmbyllje të këtij kapitulli kandidati trajton aspektet kryesore të jehonës së likundimit të Shaban Shalës në të gjitha ngjarjet e Kosovës që zhvillohen pas likundimit të tij deri në luftën e fundit shqiptaro-serbe që kurorëzohet me çlirimin e Kosovës pas luftës heroike të UCK-së në vitet 1998-99.

Përfudnim dhe propozim

Disertacioni i doktoraturës me titull “Zhvillimet historike në Llap dhe Diplomacia Evropiane 1912-1963” të kandidatit Mr. Sc. Sadri Rexhepi paraqet analizë të thelluar të një periudhe historike shumë të rëndësishme për rajonin e Llapit por edhe për Kosovën veriperëndimore. Kandidati ka arritur që në mënyrë përmbajtësore ti trajtojë çështjet e lidhura me problemin e përcaktuar të hulumtimit duke i paraqitur në mënyrë të qartë edhe rezultatet e arritura.

Nisur nga vlerësimet e sipërthëna, Komisioni për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës me titull “Zhvillimet historike në Llap dhe Diplomacia Evropiane 1912-1963” të kandidatit Mr. Sc. Sadri Rexhepi, konstaton se ky disertacion i doktoraturës i plotëson kriteret e përcaktuara dhe i sugjeron Këshillit Mësimor –Shkencor të Fakultetit Filozofik që ta aprovojë këtë raport dhe të lejoj mbrojtjen publike.

Komisioni:

1.Prof.Dr. Vebi Xhemaili(kryetar)

2.Prof.Dr. Zeqirja Rexhepi(anëtar)

3.Prof.Dr. Nuri Bexhet(anëtar)

4.Doc.Dr.Isak Sherifi(anëtar)

5.Prof.Dr.Zeqirja Idrizi (mentor)

